



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KRYETARI

Nr. 1146 prot.

Himarë, më 26 03.2021

URDHËR

Nr. 72, datë 26. 03.2021

PËR

**“VENDOSJEN E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE DHE VENDET E AFISHIMIT
GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE”**

Bazuar në nenin 8, 9, 64 të ligjit nr.139/2015 “ Për vetqeverisjen vendore”, nenit 79 të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë i ndryshuar”, udhëzimit nr.1 datë 31.05.2017 (ndryshuar me vendimin nr153 datë 11.04.2019) të KQZ “Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”, nenit 24 të ligjit 90/2017 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8580 datë 17.02.2020 “Për partitë politike”, ligjit nr. 8224 datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe komunës” azhurnuar me ligjin nr.8335 datë 23.04.1998;

URDHËROJ:

1. Pranë zyrave dhe ambjenteve të çdo njësie administrative të Bashkisë Himarë të kryhet afishimi i materiale edukative zgjedhore, në dispozicion të KQZ ose palëve të treta që nuk promovojnë fushatën e një subjekti të caktuar zgjedhor.
2. Në vendet e afishimit subjektet zgjedhore lejohen të afishojnë vetëm materiale të programeve të tyre zgjedhore.
3. Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore lejohet përdorimi dhe afishimi i materialeve propagandistike zgjedhore statike në një distancë jo më të madhe se 5 metra larg zyrës elektorale të subjektit zgjedhor.
4. Të gjitha subjektet zgjedhore duhet të japin informacion për adresat e sakta të zyrave elektorale. Brenda 5 ditëve bëhet verifikimi i vendodhjes së tyre dhe respektimi i dispozitave të vendimit nr.153 datë 11.04.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për afishimin dhe vendosjen e materialeve propagandistike.

5. Nëse materialet propagandistike të subjekteve zgjedhore vendosen në kundërshtim me kriteret e përcaktuara nga udhëzimi i KQZ dhe Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Himarë, Policia Bashkiake merr masa të menjëhershme për heqjen e tyre.
6. Për ndjekjen e këtij urdhëri ngarkohet Drejtorja e Shërbimeve Publike dhe Mirëmbajtjes, Sektori i Emergjencave Civile, Policia Bashkiake.
7. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BASHKISË

Jorgo Goro

